

KONTRATË SHITJE TË KUOTAVE TË KAPITALIT TË SHOQËRISË

Sot, më datë 27/04/2021, palët e mëposhtme:

Znj. Ledia Dervishi, lindur më 24.01.1989, shtetase shqiptare, banuese në Tiranë, mbajtëse e Kartës së Identitetit me nr. personal I95124051J, me zotësi të plotë për të vepruar (që më poshtë do të quhet "Blerësi").

DHE

Z. Aldo Dervishi, lindur më 03.03.1985, shtetas shqiptar, banues ne Tirane, mbajtës i Kartës së Identitetit me nr. personal I50303056E; (që më poshtë do të quhet "Shitësi").

Shitësit dhe Blerësi do të referohen bashkerisht si "Palët".

Palët bien dakort të nënshkruajnë këtë kontratë shitje të kuotave të shoqërisë me kushtet e mëposhtme:

DEKLARIME PARAPRAKE

Shitësi dhe blerësi janë ortakë zotërues të kapitalit të shoqërisë **ABING Shpk** me NUIS M01327019H, me seli në Rruga Abdyl Frasheri 8, Hyrja nr 7, Ap.25, 1019, Tirane (këtu e mëposhtë referuar si "Shoqëria").

Kapitali i shoqërisë është ndarë në 4 (katër) pjesë.

Shitësi zotëron 20% të kapitalit të shoqërisë ABING Shpk.

Blerësi zotëron 20% të kapitalit të shoqërisë ABING Shpk.

Neni 1

Objekti i Kontratës

- 1.1 Me anë të kësaj kontrate Shitësi i transferon Blerësit me anë të shitblerjes, kuotën e tij që përkon me 20% të kapitalit të Shoqërisë me vlerë nominale 20.000 Lekë (njëzet mijë ALL).
- 1.2 Blerësi deklaron se pranon të blejë pjesët (kuotat) e kapitalit të Shoqërisë.
- 1.3 Transferimi nëpërmjet shitblerjes do të kryhet në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe më veçanërisht me dispozitat e Kodit Civil Shqiptar dhe Ligjit Nr. 9901/2008 të ndyshuar, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Neni 2

Çmimi dhe mënyra e pagesës

- 2.1 Transferimi i pjesës (kuotës) së kapitalit të shoqërisë sipas përshkrimit të nenit 1 të kësaj kontrate nga Shitësit tek Blerësi do të kryhet përkundrejt pagesës prej:
- 20.000 Lekë (njëzet mijë ALL) ndaj Shitësit Z. Aldo Dervishi.
- 2.2 Palët deklarojnë së çmimi i përcaktuar në nenin 2.1 të kësaj kontrate është paguar tërësisht nga blerësi në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate.

Neni 3
Kalimi i Pronësisë

- 3.1 Pas nënshkrimit të kësaj kontrate Blerësi bëhet zotëruar i 40% të kapitalit të Shoqërisë, titullar i vetëm i të gjitha të drejtave dhe detyrimeve që lidhen me to, dhe përfitues i vetëm i fitimeve të Shoqërisë, sipas përcaktimeve në Statutin e Shoqërisë.

Neni 4
Garancitë

- 4.1 Shitësi deklaron dhe garanton Blerësin se pjesa (kuota) e kapitalit të shoqërisë objekt të kësaj kontrate, është e transferueshme dhe e lire nga çdo barrë, hipotekë apo çdo mjet tjetër për sigurimin e ekzekutimit të detyrimit në përputhje me Legjislacionin shqiptar në fuqi.

Neni 5
Forca Madhore

- 5.1 Asnjëra nga Palët nuk do të konsiderohet përgjegjëse në rast se plotësimi i çfarëdoq dispoziçe vendosur në këtë Kontratë do të vonohet ose do të ndalohet për shkak të forcave madhore dhe në mënyrë të vecantë për shkaqet si, revolucione, çrregullime, lëvizje popullore, luftra, greva, zjarre, përmbajtje, tërmete, fenomene të natyrës, shtetëzime, shpronësime, ose akte të pushtetit qëndror apo lokal që kufizojnë lirinë personale apo të sipërmarrjes.

Neni 6
Interpretimi i Kontratës në tërësi

- 6.1 Çdo kusht apo formulim që mund të sjellë paqartësi do të interpretohet në kontekstin e tërësisë së Kontratës dhe brenda qëllimit që i bëri Palët të nënshkruajnë këtë Kontratë.

Neni 7
Legjislacioni i zbatueshëm

- 7.1 Për sa i përket çështjeve që kjo Kontratë nuk i rregullon shprehimisht, ato do të rregullohen nga dispozitat e neneve të Kodit Civil i Republikës së Shqipërisë si dhe ligje, dispozita e norma të tjera që janë në fuqi, të cilat drejtëpërdrejtë apo tërthorazi lidhen me objektin e kësaj kontrate.

Neni 8
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 8.1 Palët bien dakort që çdo mosmarrëveshje që mund të lindë nga interpretimi dhe/ose zbatimi i kësaj kontrate do të zgjidhet me mirëkuptim nëpërmjet bisedimeve mes Palëve. Në rast se bisedimet nuk do të japin rezultat, atëherë konflikti do të zgjidhet nga Gjykata e Shkalles së Parë Tiranë Shqipëri.

Neni 9
Shpenzimet

- 9.1 Shpenzimet për regjistrimin e kësaj kontrate pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit do të jenë në ngarkim të Blerësit.

Neni 10
Ndryshimet

- 10.1 Çdo ndryshim i përmbajtjes së kësaj Kontrate, duhet të bëhet me shkrim dhe do të firmoset nga Palët.

Donjelo Zallo

Neni 11
Hyrja ne fuqi


11.1 Kjo Kontratë hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të saj nga Palët.

Neni 12
Gjuha e kontratës

12.1 Kontrata perpilohet në 4 kopje të njëjta në gjuhën Shqipe.

Palët

SHITËSI

Aldo Dervishi 

ALDO DERVISHI

BLERËSI

Ledia Dervishi 

LEDIA DERVISHI

Songelo Ma 